

LEXIMI I RAPORTI TË KREDIMARRËSIT

Raporti i kredimarrësit përmban të dhëna në lidhje me Kredinë/të e akorduara kredimarrësit, kolaterale të vendosura si garanci, si dhe kredinë/të në të cilat kredimarrësi qëndron në cilësinë e personit të lidhur.

Raporti i kredimarrësit ndahet sipas seksioneve të mëposhtëm:

A. Seksioni I “Të dhëna të Përgjithshme”- Pasqyron të dhënat identifikuese të kredimarrësit;; adresën, numrin e kontaktit etj.

B. Seksioni II “Kredimarrës si subjekt i drejtpërdrejtë-” në këtë seksion pasqyrohen të dhënat, për të gjitha kreditë e akorduara ndaj kredimarrësit, si në vijim:

1. **Lloji i kredisë :** Kredi; Overdraft; Kartë krediti; Letër kredi; Garanci; Qira Financiare; Faktoring; Kredi qarkulluese të ndryshme nga overdraftet dhe kartat e kreditit ; të tjera.
2. **Data e disbursimit**– data në të cilën është realizuar transferimi i fondeve për llogari të kredimarrësit.
3. **Shuma e Aprovuar**– Shuma e aprovuar e kredisë
4. **Shuma e Disbursuar**– Vlera e transferuar për llogari të kredimarrësit. Kjo vlerë mund të jetë më e vogël ose e barabartë me shumën e aprovuar të kredisë.
5. **Kësti** – Për kreditë me këste, pasqyrohet detyrimi i kredimarrësit për shlyerjen e kredisë sipas periodicitetit që parashikon marrëdhënia kontraktuale e lidhur me institucionin financiar.
6. **Teprica e kredisë** – Shuma e mbetur e kredisë (teprica e rregullt) .
7. **Shuma e Vonuar** – pasqyron detyrimin e papaguar në kohë të kredimarrësit. Ky detyrim ndahet në Principal në Vonesë dhe Interes në Vonesë.
8. **Monedha**– Monedha origjinale e kredisë.
9. **Statusi i klasifikimit:** Identifikon cilësinë e shlyerjes së kredisë. Klasifikimi i kredisë realizohet sipas statuseve : 0 – Standard; 1 – Në ndjekje; 2 – Nënstandard; 3 – E dyshimtë; 4 – E humbur; 5 – E paguar; 6 – E fshirë nga bilanci;
 - Kreditë e klasifikuara në statuset në 2 statuset e para : (0) – ‘Standard’ dhe (1) – ‘Në ndjekje’, *kategorizohen në grupin e kredive cilësore.*
 - Kreditë e klasifikuara në 3 statuset e fundit : (2) - ‘Nën standard’, (3) – ‘E dyshimtë’, (4) – ‘E humbur’ *kategorizohen në grupin e kredive me probleme*
10. **Data Efektive**- Periudha për të cilën janë raportuar të dhënat.
11. **Data e Përditësimit**- Data në të cilën është realizuar raportimi i të dhënave.
12. **Datë maturimi**-data kontraktuale e përfundimit të kohëzgjatjes së kredisë.
13. **Qëllimi i Kredisë**-destinacioni i përdorimit të fondeve.
14. **Numri i kësteve në vonesë**-Në rastet kur është e aplikueshme, raporti shfaq informacion mbi numrin e kësteve të pa paguara për kredinë, për periudhën e raportimit të të dhënave;
15. **Statusi i kredisë**-Në rastet kur është e aplikueshme raporti pasqyron informacion mbi:
 - a. *Kreditë në proces ekzekutimi* - Ky status identifikohet në Raport, për kreditë për të cilat banka disponon një Urdhër Ekzekutimi të lëshuar nga gjykata me qëllim shlyerjen e pretendimeve kundrejt huamarrësve.
 - b. *Kreditë e shitura*- Identifikohen në raport ato kredi të cilat janë shitur tek subjekte të tjera financiare
 - c. *kreditë e ristrukturuara*- Identifikohen në Raport ato kredi të cilat plotësojnë kriteret si të tilla bazuar në rregulloret e administrimit të rrezikut të kredisë.

Në këtë fushë pasqyrohen gjithashtu informacion kur kredia është e klasifikuar si Kredi e Paguar “statusi 5” si dhe kredi e fshirë nga bilanci “statusi 6.”

16. **Date**- Data në të cilën kredia ka kaluar në proces ekzekutimi; ristrukturuar apo shitur, si dhe data kur është klasifikuar për herë të parë me statusin 5” Kredi e paguar” dhe Statusin 6”Kredi e fshirë nga Bilanci.
17. **Historiku i klasifikimit** – pasqyron klasifikimin e kredisë, për 24 periudhat më të fundit, duke filluar nga periudha aktuale.
18. **Kolaterali** – pasqyron tërësinë e kolateraleve të vendosura si garanci për kredinë.

C. Seksioni III- Kredimarrësi si person i lidhur

Në këtë seksion pasqyrohen të dhëna për të gjitha kreditë në të cilat një individ/person juridik qëndron në cilësinë e personit të lidhur në një nga rolet :Garantues; Bashkëshort; Drejtor/Administrator; Pronar/aksionar; Bashkëkredimarrës; Firmë e lidhur; Garantor Financiar

Informacioni që shfaqet për kredinë si person i lidhur, është i njëjtë me të dhënat që paraqiten në Seksionin II .

D. Seksioni IV-Ekspozimi i kredimarrësit në sistem(në lekë)- Pasqyron totalin e kredive si kredimarrës të drejtpërdrejtë dhe si person i lidhur. Ky seksion shfaq informacion mbi:

- Numrin total të kredive
- Shumën totale të aprovuar
- Shumën totale të disbursuar
- Shumën totale të kësteve mujore
- Tepërcën në total të mbetur të kredive, si dhe
- Shumën në total të vonuar

E. Seksioni V-Pesë kërkimet më të fundit për kredimarrësin shfaq informacion për datën dhe emrin e institucionit financiar i cili ka bërë kërkimin në sistemin e Regjistrit të Kredive

Në rast të konstatimit të të dhënave të paplota dhe/ose pretendimeve lidhur me saktësinë e tyre, kredimarrësi paraqet fillimisht kërkesën për rishikimin/saktësimin e të dhënave tek raportuesi përgjegjës i të dhënave. Nëse nga verifikimi i kryer nga raportuesi i të dhënave rezulton se të dhënat që kërkohet të rishikohen janë të sakta por kredimarrësi nuk bie dakord me to dhe vijon të ketë pretendime lidhur me të dhënat e tij, mund të paraqesë kërkesën për rishikim pranë Bankës së Shqipërisë.